

POEZIA E MARTIN CAMAJT MES HERMETIZMIT DHE ERRËSISË KUPTIMORE

Jolanda LILA

Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët (QSPA)
Tiranë

Punim studimor

Përmbajtje e shkurtër: Çështja e hermetizmit dhe pikëtakimet e autorit Martin Camaj me të janë ende në vazhden e diskutimeve ndër studiues. Një pjesë e etiketojnë këtë poezi si trajtë të mirëfilltë të hermetizmit, ndërsa një pjesë tjetër e shohin si errësim të shprehjes poetike, që vjen si përpjekje për të lartësuar nivelin estetik, gjë e cila nuk duhet barazvlerësuar doemosdo-shmërisht me hermetizmin. Përcaktimet dhe klasifikimet për poezinë e tij janë të larmishme, si: poezi surrealistë, neorealiste, strukturaliste, hermetike, veriste, moderniste, postmoderniste etj., por orientimi i përgjithshëm dhe ngatërrimi më i madh bëhet mes dy tipologjive shkrimore: hermetizmit dhe errësisë kuptimore. Në këtë punim do të qartësojmë tiparet e këtyre dy tipologjive shkrimore dhe nivelin e pranisë së tyre në poezinë e Camajt.

Fjalë çelësa: *poezi moderne, hermetizëm, errësi gjuhësore, simbole*

Shumë prej studiuesve që e përlegjin si të padiskutueshëm kanalizimin e poezisë së Martin Camajt në hullinë e hermetizmit, udhëhiqen prej dy rrethanash, njëra prej të cilave është brendaletrare dhe lidhet me vetë tiparet e gjuhës poetike, ndërsa rrethana tjetër është jashtëletrare dhe lidhet me periudhën e qëndrimit në Romë të Camajt, ku mendohet se ai ka marrë mësim nga G. Ungareti, një prej përfaqësuesve më në zë të hermetizmit në letërsinë italiane. Bashkëpunimi me Ungaretin dëshmohe

edhe përmes pohimit të Camajt, në një intervistë të dhënë në nëntor të vitit 1991 për gazetën "Allgemeine Zeitung", ku e cilëson Ungaretin si "poet i madh por profesor i dobët"¹. Përveç tjerash, tezat teorike të Ungaretit mbi poezinë duket sikur gjejnë mishërim edhe në kredon letrare të Martin Camajt, gjë që nënkupton pashmangshmërinë ndikuese. Pavarësisht ndikimit në frymën abstraguese të poezisë dhe largimit nga skemat tradicionale poetike, linjat komparative mes këtyre dy autorëve janë larg njëra-tjetrës, për shkak se botëkuptimi i tyre kulturor dhe perceptues është tejet i ndryshëm dhe për pasojë, rrekja për të gjetur pikëtakime duket pa themele të qëndrueshme mbështetëse dhe të çon në rrugë pa krye. Kjo ndodh për faktin se, pavarësisht ndonjë elementi ndikues, poezia e Camajt është një formë origjinale e shprehjes moderne, që ngrihet mbi rrënjët e traditës poetike e kulturore shqiptare.

Poezia e tij qëndron në dysinë mes hermetizmit dhe errësisë kuptimore si tipar i modernitetit. Skajshmëria e qëndrimeve për praninë apo mospraninë e njërës element përngjan jo objektive. Mohimi i hermetizmit në poezinë e Camajt përbën një qasje të gabuar kërkimore, ashtu sikundër tingëllon tejet i ekzagjeruar edhe orientimi tërësor i interpretimit të vepërës së tij tek hermetizmi. Për ta zhdrivilluar më tej këtë pohim, është e udhës që të qartësohen tiparet e poezisë së tij, të cilat janë në përputhje apo në kundërshti me hermetizmin. Andaj, për t'i nxjerrë në dritë këto tipare, është e nevojshme që të sqarohet fillimisht se çfarë është hermetizmi.

Në rrafshin etimologjik, mendohet se fjala hermetizëm vjen prej emrit të dijetarit egjiptian Hermes Trismegisti, i cili njihej si themeluesi i alkemisë (shkencës mbi gjërat e fshehta dhe mistike). Në themel të teorisë alkimiste ishte koncepti se metalet e thjeshta mund të shndërrohen në ar ose në argjend me anë të "gurit të urtësisë", i cili në të vërtetë as që ekzistonte në natyrë. Ndërsa neoplatonikët e konsideronin Hermes Trismegistin si Zotin egjiptian që mbante sekretin e krijimit, të artit, të shkencës dhe të fjalës.

Në rrafshin kuptimor, fjala hermetizëm është e barasvlershme me fjalën e fshehtë dhe okulte. Ndërsa më vonë kuptimi derivoi në shenjimin e diçkaje të mbyllur e të izoluar.² Njëllor si enët që mbyllen hermetikisht

¹ Ardian Klosi, *Takim me Martin Camajn* (në vend të parathënies), vepra letrare 1, Apollonia, Tiranë, 1996, f. 25.

² *Gnosis and hermetism from Antiquity to Modern Times*, Edited by Roelof van den Broek and Wuoter J. Haneegraff, State University of New York Press, 1998, f. 15.

për të mos depërtuar ajri nga jashtë, ashtu është edhe teksti hermetik i mbyllur ndaj qartësisë dhe fijeve e referencave konkrete kuptimore. "Fjala hermetizëm nga sferat e tjera të jetës u bart në letërsi, për të treguar ato vepra që nuk janë të hapura, por të mbyllura, që nuk janë të qarta, por të paqarta, domethënë ato vepra, idetë dhe porosia e të cilave nuk mund të nxirren lehtë".³

Në rrafshin historik, ekzistenca e hermetizmit është po aq e vjetër sa dhe vetë poezia. Pavarësisht se hermetizmi konsiderohet si tipar i poezisë moderne, që doli në skenë në fundin e shekullit XIX dhe fillimin e shekullit XX, me bulëzimin e rrymave parnasiste, simboliste, surrealistike etj., trajta të qenësisë së tij i gjejmë që në agimin e krijimtarisë poetike. Për poetin antik, Likofronin thuhet se askush nuk mund ta kuptonte dhe se kjo gjë e kishte bërë të njohur.⁴ Kjo moskuptueshmëri është emërtuar si "mosasimilim" nga Fridrih Hugo, i cili thekson se Rembrandi dhe Mallarmeja nuk ishin të perceptueshëm apo të asimilueshëm nga publiku i gjerë, madje kjo nuk ka ndodhur as në ditët e sotme, megjithatë për ta është shkruar vërtetë shumë. Mosasimilimi, apo mosperceptimi është tipik për pothuaj të gjithë poetët bashkëkohorë⁵. Ndërsa themeluesi i modernitetit në poezi, Charl Bodleri thoshte: "... është një lavdi e sigurt të mos jesh i kuptueshëm"⁶.

Dukuria e mosasimilimit për shkak të tipareve të brendshme tekstore dhe shprehjes gjuhësore ezoterike krijon edhe ngatërresat konceptuale mes hermetizmit dhe errësisë kuptimore.

"Errësira kuptimore është një prej tipareve të hermetizmit, por nuk mund të identifikohet plotësisht me të. Paqartësia shkaktohet kur të dyja lidhen me karakterin e hapur të veprës letrare".⁷ Teoricienë të mendimit letrar i gjejmë ndasitë mes këtyre dy përbërësve në disa drejtime: Së pari, në aspektin përmbajtjesor ekziston një tis përndarës mes këtyre dy elementeve. Hermetizmi ka në thelb filozofinë ontologjike, ku qenia paraqitet si një bërthamë e pandryshueshme, që ekziston pavarësisht nga

³ Agim Vinca, *Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945-1980)*, Rilindja, Prishtinë, 1985, f. 383.

⁴ Po aty, f. 383.

⁵ Fridrih Hugo, *The structure of modern poetry (From the Mid-Nineteenth to the Mid-Twentieth Century)*, North-eastern University Press, Evanston, USA (Translation is based on the revised German edition of 1967), 1974, f. 6.

⁶ Po aty, f. 3.

⁷ Luan Topçiu, *Hermetizmi si përqendrim maksimal: hyrje në poezinë e Martin Camajt*, në "Haemus", Bukuresht, nr. 2-3, 1999. (versioni elektronik)

trajtat e veçanta të saj. Ndërsa poezia moderne me errësi gjuhësore ka një shtrirje më të gjerë, ajo nuk është e fokusuar vetëm në sferën ontologjike, por zgjerohet në shumë dimensione interpretative, duke qenë se thelbi i saj është ambiguiteti. Gjithashtu, në poezinë hermetike shpërfaqet një botëkuptim i veçantë mbi botën, ku ajo funksion sipas një rendi tjetër dhe për t'u zbërthyer e kuptuar simbolika funksionuese e këtij rendi kërkohet pranimiti i konvencionalizmit të një mesazhi të caktuar.

"Në epokën e re të misticizmit poezia kalon nga një purizëm joestetik në një medium shprehës. Për modernistët, poezia është e lidhur me besimet okulte. Shpallja e hermetizmit, pra është një sistem i mbyllur, që profetëson vetëpërbushjen dhe të vërtetat e saj janë në dispozicion vetëm për ata që tashmë e dinë të vërtetën"⁸. Versioni i popullarizuar okult, bota e fenomeneve të dyshimta, të gjitha mjetet e spiritualizmit, astrologjia, projektimi astral, parapsikologjia burojnë nga hermetizmi në atë që është një parim bazë i aftësive hyjnore tek njeriu i shtypur ndër shekuj e i nënshtruar ndaj rregullave fetare.⁹

Në poezitë me errësi gjuhësore nuk ka asnjë shenjë konvencionaliteti, gjithçka që interpretohet e perceptohet nga lexuesi është e mundshme parimisht dhe mesazhet janë të pafundme e asnjëherë shteruese. E thënë ndryshe, në lirikën hermetike është shumë e rëndësishme gjetja dhe zbërthimi i mesazhit të poetit, ndërsa në lirikën me errësi gjuhësore mesazhi i krijuesit nuk ka kurrfarë vlere përpara lirshmërisë së imagjinatës dhe interpretimeve të receptuesit. Në këtë kuadër, është e njohur thënia/teoria e Roland Barthesit "Autori vdiq", në kuptimin që vëmendja duhet të përqendrohet tërësisht tek marrëdhënia e lexuesit me tekstin dhe jo tek orvatja për të gjetur atë që kërkon të thotë autori.

Poezia hermetike ngrihet mbi simbole me vlerë mitike e arketipore e mbi simbole origjinale, ndërsa poezia me errësi gjuhësore ndërtohet, përveçse me simbole të tilla, edhe me shenja gjuhësore që, në sajë të pranëvënies e kombinimeve me shenja të tjera, ndërtojnë kanale të larmishme komunikative me receptuesit.

Poezia e Martin Camajit përbëhet jo vetëm nga simbolet mitike, por edhe nga shenjat gjuhësore që kërkojnë interpretime semiotike falë konteksteve në të cilat vendosen dhe kombinohen. Pikërisht për shkak të bashkëjetesës së këtyre shenjave dhe larushisë kuptimore që shpërfaqet

⁸ *Gnosis and hermetism from Antiquity to Modern Times*, Edited by Roelof van den Broek and Eüoter J. Haneegraff, State University of New York Press, 1998, f. 14.

⁹ Po aty, fq. 15.

prej tyre, studiuesi Shaban Sinani pohon se, "ajo që quhet pjesë e errët e krijimtarisë së Camajt nuk lidhet me ndonjë doktrinë apo me parime krijuese që e pririn letërsinë nga hermetizmi. Poezia e Camajt mbështetet fort mbi figurën gjuhësore, mbi frazeologjinë dhe idiomatikën popullore dhe mbi të gjitha mbi një sfond leksikor të paranjësuar. Poetët modernë janë prirur shpesh të mbështeten në figurën gjuhësore. Por jo duke e çliruar atë prej veshjes sipërfaqësore me qëllim zbulimin e thelbit të sendeve dhe shenjave. Vetë karakteri i këtyre mjeteve, thelbësisht të lidhura me traditën, nuk premtion mundësi zhvillimi të formalizmit letrar dhe të errësimit artificial kuptimor të poezisë."¹⁰

Përçasja e bërthamës përmbajtjesore mes këtyre dy tipareve të poezisë moderne na çon tek një tjetër aspekt përndarës që lidhet me raportit mes veprës dhe lexuesit. Hermetizmi është i mbyllur në planin e njohjes, kurse errësira kuptimore është e hapur përmes pranimit të papërcaktueshmërisë. Kjo do të thotë se nëse poezia hermetike pranon një apo disa zgjidhje, errësimi kuptimor nënkupton shumësi zgjidhjesh, deri edhe kundërtënëse me njëra-tjetrën.

Në një farë mënyre, mund të themi se hermetizmi lidhet krejtësisht me izolimin semantik që autori i bën një poezie dhe detyra e receptuesit është të depërtojë në këtë sistem izolues. Sigurisht që kuptimi nuk hamendësohet rreth asaj se çfarë ka pasur në mend autori, por gjendet ose ndryhet ndër vargje dhe duhet deshifruar përmes një çelësi dekodifikues. Ndërkohë që errësira kuptimore ka të bëjë më tepër me përmbajtjen, që gjenerohet prej shprehjes gjuhësore.

"Camaj jo vetëm nuk ka fobi ndaj njohjes, por i bëhet lexuesit pri-jës për të gjetur çelësat e ndërftjes në kuptimet e kriptuara brenda tekstit"¹¹. Ndërkohë që hermetikët e ngritën në mit mjegullnajën e moskuptimësisë, vetë Camaj ishte i prirur për të bërë të kundërtën, përderisa shumë prej poezive të tij janë pajisur me shpjegime sqaruese në fund të tekstit, gjë që shërben si çelës orientues për zbërthimin e kuptimeve të mundshme.

Nga ana tjetër, tiparet ligjërimore të poezisë shihen si hermetike, sepse përveçse një formë estetike, kjo ishte një mënyrë komunikimi, deri e natyrshme, që lidhej me vetë karakterin e Martin Camajt. "Hermetizmi

¹⁰ Shaban Sinani, *Camaj i paskajuar (Rreth tipologjisë së llojeve në veprën e Martin Camajt)*, Qendra e Studimeve Albanologjike & Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2011, f. 66.

¹¹ Po aty, f. 66-67.

i Camajt varet shumë prej mënyrës lakonike të ligjërimin burrnor të malësisë. Ai lloj ligjërimi, thellësisht i ndërgjegjshëm për forcën e fjalës, i len shumë shpesh një vend të madh heshtjes. Për mendësinë e malsorit fjala e tepërt e damton komunikimin, e zbeh idenë dhe e zhurmon vetë kumtuesin. Kjo lloj urtie ka mbijetuar në malet tona deri në shekullin e 20-të."¹² Pra, tiparet e gjuhës lakonike të malësorit dhe mentaliteti konservativ i shprehisë, ku flitet pak për të nënkuptuar shumë, duket se ka lënë gjurmë të pashlyeshme në karakterin e autorit, gjurmë të cilat i reflekton edhe në procesin shkrimor. "Shumësia e fjalëve në komunikimin e esenciales asht shenjë vorfnie dhe jo pasurie, e Camaj don me na kumtue me anën e vargut thelbin e shpirtit të vet. Në këtë mënyrë Fjala bahet sogje e shpirtit dhe e ruen atë prej bdarjes dhe prej shlyemjes që i ban kuptimit shumësia e fjalëve".¹³

Më shumë sesa në tiparet e ndërtimit të shprehjes gjuhësore, tisi përndarës mes poezisë hermetike dhe asaj me errësi kuptimore shtrihet në planin e receptimit të përmbajtjes dhe sigurisht kjo nuk ndihmon shquarjen prerazi të tipareve të secilit element, sepse edhe vetë poetët gjatë krijimtarisë së tyre i hibridizojnë me njëri-tjetrin, në funksion të shprehjes moderne. Kështu ka proceduar edhe poeti ynë, i cili herë është krehur në ujërat e hermetizimit me përdorimin e paradokseve abstrakte filozofike e herë të tjera, në poezinë me errësi kuptimore, duke e selitur shprehjen gjuhësore deri në pavarësimin tërësor prej përmbajtjes përcaktuese dhe konkretizuese, e duke hapur në këtë mënyrë shtigjet e plurivocitetit receptues.

Aftësia njohëse është e mundur tamam me poezinë që nuk është e destinuar kryesisht të jetë e kuptueshme, poezi e cila, siç shkruante T.S. Eliot, përmban moskuptimin "kënaq prirjen e lexuesit". Eliot shkon më tej duke thënë: "Disa poetë janë të pashtuar drejt çdo kuptimi, sepse ai duket i tepërt apo i panevojshëm dhe ata shohin pamundësinë e fuqisë poetike që vjen nga të çliruarit e vetes nga kuptimi". Çdo poezi është e njohshme dhe e përshkrueshme, megjithëse ajo mund të përmbajë një liri kaq të madhe, kështu që mënyra më e mirë për ta kuptuar është të dallojmë ekzistencën e kësaj lirie pa e kursyer përmbajtjen- veçanërisht deri kur (sipas Eliotit) këto përmbajtje të kenë kaq domethënie të pallogaritshme, të cilat poeti në vetvete, ndërsa shkruan, ka vetëm një njohuri

¹² Ardian Ndreca, "Martin Camaj: Në kërkim të fjalës së shlyeme", në "Hylli i Dritës", nr. 4, 2010, f. 20.

¹³ Po aty, f. 20-21.

të kufizuar për kuptimin e asaj që është duke krijuar. Njohja e çdo regjistri poetik, si një tipar parësor i fuqisë stilistike, e madhe ose plotësisht e pakuptueshme.

Dhe të tjera karakteristika mund të dallohen. Njohja mund të jetë ende shpresdhënëse, sepse ajo e drejton vetveten nga rrethanat historike, teknikat poetike, dhe në përputhje të pamohueshme me gjuhën që lidh shumicën e autorëve të ndryshëm. Përfundimisht, procesi njohës i bollëkut të kuptimeve në këto tekste, përmes vetë bashkimit (inkorporimit) në procesin kur çdo poezi provon të arrijë tek audienca: përpjekja e lexuesit si interpretim vazhdon aktin krijues të poezisë, pafundësisht dhe pakufijshmërisht.¹⁴

Poeti francez Stefan Mallarmé (1842-1898), i cili konsiderohet si një nga përfaqësuesit më të denjë të poezisë hermetike, shprehet: "ta emërtosh një objekt do të thotë t'i zhdukësh tri të katërtat e kënaqësisë që qëndron në të zbërthyerit gradual; të sugjerosh, që ëndrra." Ky parim i Mallarmés gjen mishërim në poezinë e Martin Camajt, ku objektet, fenomenet dhe idetë thjesht sugjerohen dhe nuk emërtohen e kristalizohen. "Lirika e vërtetë është e çliruar nga barra e përmbajtjes; ajo e zëvendëson të përcaktuarën me të papërcaktuarën, ekzistuesen me të mundshmen, konkretën me simbolin".¹⁵

Poezia e fazës së pjekurisë së autorit tonë është tërësisht e shkëputur nga skemat tradicionale. Ajo karakterizohet nga gjuha dhe shprehjet sintetike, me koncentrim simbolesh e ftohtësi objektive. Pikërisht këto tipare të tekstit poetik i shpien shumë studiues në etiketimin e poezisë së tij si hermetike, "ngaqë disa lexues nuk depërtojnë dot në botën e shenjave dhe simboleve shqiptare"¹⁶. Njëherësh ky mosdepërtim mund të interpretohet edhe si errësi kuptimore, ku gjuha ka një funksion paradoksal: për të shprehur nga njëra anë, e njëkohësisht nga ana tjetër, për të fshehur. Raporti mes pranive dhe mungesave përplotësohet nga intuita dhe niveli kulturor i receptuesit të vargjeve.

Radha e natyrshme e leximit të kësaj poezie nuk ka të bëjë me linearitetin e mesazhit gjuhësor. E tillë është poezia moderne, nuk kërkon

¹⁴ Friedrich Hugo, *The structure of modern poetry (From the Mid-Nineteenth to the Mid-Twentieth Century)*, Northwestern University Press, Evanston, USA (Translation is based on the revised German edition of 1967), 1974, f. 6-7.

¹⁵ Branko Milkovic, "Poezija i oblik", cituar sipas Vinca, Agim. *Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945-1980)*, Rilindja, Prishtinë, 1985, f. 386.

¹⁶ Ardian Klosi, *Takim me Martin Camajn* (në vend të parathënies), vepra letrare 1, Apollonia, Tiranë, 1996, f. 26.

lexim linear, por tabular, sepse në thelb, kjo lloj poezie, lidhet me artin e kalimit nga fjalët te sendet dhe jo e kundërta. Fjalët duhet të krijojnë një imazh a një përshtypje të caktuar në mendjen e lexuesit dhe këtë imazh e mbart me vete çdo lexues i Camajt.

Pavarësisht qasjeve argumentuese të raportit që Martin Camaj vendos me hermetizmin, autori vetë nuk e pranon përfshirjen në asnjë kanon a model, qoftë brenda sistemit letrar, qoftë jashtë tij. Ai e kundërshton qartësisht etiketimin e krijimtarisë së tij si hermetike, teksa thotë "*...shtimja në kallëpe më ban të trishtë, si në hymjen e "Poesie" të Guzzetta-s me shokë. Unë nuk jam hermetik; ata çka ata marrin për hermetizëm dhe në poezinë tonë popullore ashtë simbolizëm, në daç dhe me prejardhje orientale, por simbolizëm apo alegorizëm*". (Letër e Martin Camajt dërguar Arshi Pipës, 21 shkurt 1986.¹⁷

Martin Camaj nuk ka pranuar asnjë klishe dhe asnjë kuadër përcaktues për krijimtarinë e vet, përveçse nuk ka mohuar ndikimet që ka pasur prej strukturalizmit klasik në gjuhësi. Përçafimi i drejtimit themelor të gjuhësisë moderne është tregues edhe për orientimin e shprehjes së tij poetike, si shenjë e shenjave, në të cilën të duhet të davarisësh shtresëzimet e reve kuptimore. Futja e kësaj lloj gjuhe ndër brazdat e errësisë kuptimore apo hermetizmit përbën kanonizimin e padrejtë të një poezie, e cila vërtitet lirisht herë në njëerën e herë në tjetrën anë dhe dora-dorës, kapërcen edhe përtej tyre drejt një sistemi të mëvetësishëm e origjinal krijues.

Nga e gjithë kjo analizë, arrijmë në përfundimin se, së paku në mënyrë të vetëdijshme, autori nuk ka pasur synim që të zbatojë modele të caktuara, sepse poezitë e tij nuk janë trajta formale të kallëpeve të gatshme krijuese, por shquhen për natyrshmërinë dhe për tiparet individuale. Gjithashtu, është pranuar edhe ndër studiues se, hermetizmi është më tepër shprehje e ndikimit të jashtëm në letërsinë shqipe, pra që nuk ka rrjedhur në mënyrë të natyrshme si nevojë dhe traditë e shprehjes poetike, por si një prirje ambicioze e disa krijuesve, fillimisht në Kosovë e më pas në Shqipërinë shtetërore për ta errësuar shprehjen poetike, proces

¹⁷ Cituar sipas Shaban Sinani, *Camaj i paskajuar (Rreth tipologjisë së llojeve në veprën e Martin Camajt)*, Qendra e Studimeve Albanologjike & Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2011, f. 37. (Citimi është shkëputur sipas Jonida Xhyra-Entrof, "Beruhungspunkte zwischen Ungaretti und Camaj", botuar në "Wir sind die Deinen", përgatitur nga B. Demiraj, "Harrassowitz Verlag", 2010, f.114.

i cili në disa raste ka prekur nivelin e shabllonizmit dhe epigonizmit.¹⁸ Për shkak të rrethanave historiko-letrare, rasti i Camajt është i ndryshëm: poezitë e tij u kultivuan në mjedisin letrar evropian; ai sintetizoi tiparet e modernitetit bashkëkohor në konceptet, strukturën dhe funksionet poetike.

Literatura:

Gnosis and hermetism from Antiquity to Modern Times, Edited by Roelof van den Broek and Wuoter J. Haneegraff, State University of New York Press, 1998.

Hugo, Friedrich. *The structure of modern poetry (From the Mid-Nineteenth to the Mid-Twentieth Century)*, Northwestern University Press, Evanston, USA (Translation is based on the revised German edition of 1967), 1974.

Klosi, Ardian. *Takim me Martin Camajn* (në vend të parathënies), vepra letrare 1, Apollonia, Tiranë, 1996.

Konferenca *Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe Albanologu (në 85-vjetorin e lindjes)*, botim i Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër, 2011.

Ndreca, Ardian. "Martin Camaj: Në kërkim të fjalës së shlyeme", në *Hylli i Dritës*, nr. 4, 2010.

Qosja, Rexhep. "Kritika dhe paqartësia", *Kontiunitete*, Rilindja, Prishtinë, 1972.

Sinani, Shaban. *Camaj i paskajuar (Rreth tipologjisë së llojeve në veprën e Martin Camajt)*, Qendra e Studimeve Albanologjike & Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2011.

Topçiu, Luan. "Hermetizmi si përqendrim maksimal: hyrje në poezinë e Martin Camajt", në *Haemus*, Bukuresht, nr. 2-3, 1999. (versioni elektronik)

Vinca, Agim. *Struktura e zhvillimit të poezisë shqipe (1945-1980)*, Rilindja, Prishtinë, 1985.

¹⁸ Shih për më gjerë: Rexhep Qosja, "Kritika dhe paqartësia", *Kontiunitete*, Rilindja, Prishtinë, 1972, f. 293-303. Si dhe Ledia Dushi, "Martin Camaj, larg dhe afër Shqipërisë", botuar në përmbledhjen me kumtesa të mbajtura në konferencën shkencore: *Martin Camaj për kulturën shqiptare. Shkrimtari dhe Albanologu (në 85-vjetorin e lindjes)*, Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, 2011, f. 95-99.

MARTIN CAMAJ'S POETRY BETWEEN HERMETICISM AND DARK LANGUAGE

Summar

Keywords: modern poetry, hermetism, dark language, symbol

The poetry of Martin Camaj marks an entirely separate poetical system, cultivated freely and in line with the European modernism and not under the pressure of the censorship of political ideology. As a prevalent feature of this poetry we find the presence of dichotomies in the poetry's form and content. Through various text analyses we scrutinised some of the dichotomy typologies and their function, which varies from image to mirage, in the sense that the associated sequences appear and disappear at about the same time.

In a separate entry we have tried to shed light on Martin Camaj's relation to hermeticism, since there are still discussions among scholars regarding this aspect. Having dealt with the components of the hermetic poetry and dark language, we have argued that the author's intention was not to implement specific models, since his poems are not the formal output of some ready-made creative mould, but carry the distinct quality of an artless spontaneous style and distinguishing elements, which leads us more to the prevalence of dark language in his poetical expression.